



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS VUSHTTRRI

Numri i lëndës: 2022:063905

Datë: 05.09.2022

Numri i dokumentit: 03391304

P.nr.101/2022

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË – DEGA NË VUSHTTRRI - Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal, gjyqtari i vetëm gjykues Agron Maxhuni, me procesmbajtësen Bahrije Smakolli, në çështjen penale kundër të pandehurit S. C. nga fshati S.i E. komuna e Vushtrrisë, për shkak të veprës penale Vjedhja e shërbimeve nga neni 314 par.6 në lidhje me par.1 në lidhje me nenin 77 të KPRK-së, duke vendosur sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë - Departamentit të Përgjithshëm PP-II.nr.174/22, e datës 24.03.2022, më datë 05.09.2022 përpiloi, këtë:

A K T G J Y K I M

PRANOHET kërkesa e Prokurorit të shtetit, PP-II.nr.174/22, e datës 24.03.2022 andaj gjykata konform dispozitës të nenit 495 të KPPK-së, jep:

URDHËR NDËSHKIMOR

IPANDEHURI: S. C. nga i ati R. dhe e ëma Q. e vajzërisë B. i lindur më ..., në fshatin S. komuna e V. ku tani edhe jeton, me numër personal ... ka të kryer shkollën e mesme, i martuar, shqiptar, i punësuar i gjendjes së mesme ekonomike shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

SEPSE: Në periudhën e pa përcaktuar e deri më 19.08.2017 ne fshatin S. Komuna e V. me qëllim që vetës ti sjell përfitim pasuror, ka siguruar shërbime për të cilat e din se janë ne dispozicion ne këmbim të pagesës, në atë mënyrë që e ka furnizuar objektin e vetë me rrymë, pa autorizimin e KEDS-it si furnizues i autorizuar nga cili rrjet furnizues është furnizuar me energji elektrike, ashtu që është kyçur drejtpërdrejtë ne rrjet elektrik duke anashkaluar njehsorin elektrik dhe kështu ka shpenzuar energjinë elektrike e cila nuk është e regjistruar;

-Nga data 19.08.2017 e deri më 23.09.2017 ne fshatin S. Komuna e V. me qëllim që vetës ti sjell përfitim pasuror, ka siguruar shërbime për të cilat e din se janë ne dispozicion ne këmbim të pagesës, në atë mënyrë që e ka furnizuar objektin e vetë me rrymë, pa autorizimin e KEDS-it si furnizues i autorizuar nga cili rrjet furnizues është furnizuar me energji elektrike, ashtu që është

kyçur drejtpërdrejtë ne rrjet elektrik duke anashkaluar njehsorin elektrik dhe kështu ka shpenzuar energjinë elektrike e cila nuk është e regjistruar;

Nga data 23.09.2017 e deri më datën 23.03.2018 në fshatin S. me qëllim qe vetës ti sjell përfitim pasuror, ka siguruar shërbime për të cilat e din se janë ne dispozicion ne këmbim të pagesës, në atë mënyrë që e ka furnizuar objektin e vetë me rrymë, pa autorizimin e KEDS-it si furnizues i autorizuar nga cili rrjet furnizues është furnizuar me energji elektrike, ashtu që është kyçur drejtpërdrejtë ne rrjet elektrik duke anashkaluar njehsorin elektrik dhe kështu ka shpenzuar energjinë elektrike e cila nuk është e regjistruar;

Nga data 23.03.2018 e deri më datën 11.06.2018 në fshatin S. Komuna e V. me qëllim qe vetës ti sjell përfitim pasuror, ka siguruar shërbime për të cilat e din se janë ne dispozicion ne këmbim të pagesës, në atë mënyrë që e ka furnizuar objektin e vetë me rrymë, pa autorizimin e KEDS-it si furnizues i autorizuar nga cili rrjet furnizues është furnizuar me energji elektrike, ashtu që është kyçur drejtpërdrejtë ne rrjet elektrik duke anashkaluar njehsorin elektrik dhe kështu ka shpenzuar energjinë elektrike e cila nuk është e regjistruar;

Nga data 11.06.2018 e deri më datën 29.08.2020 në fshatin S. Komuna e Vushtrrisë, me qëllim qe vetës ti sjell përfitim pasuror, ka siguruar shërbime për të cilat e din se janë ne dispozicion ne këmbim të pagesës, në atë mënyrë që e ka furnizuar objektin e vetë me rrymë, pa autorizimin e KEDS-it si furnizues i autorizuar nga cili rrjet furnizues është furnizuar me energji elektrike, ashtu që është kyçur drejtpërdrejtë ne rrjet elektrik duke anashkaluar njehsorin elektrik dhe kështu ka shpenzuar energjinë elektrike e cila nuk është e regjistruar;

Nga data 29.08.2020 e deri më datën 11.09.2020, në fshatin S. Komuna e V. me qëllim qe vetës ti sjell përfitim pasuror, ka siguruar shërbime për të cilat e din se janë ne dispozicion ne këmbim të pagesës, në atë mënyrë që e ka furnizuar objektin e vetë me rrymë, pa autorizimin e KEDS-it si furnizues i autorizuar nga cili rrjet furnizues është furnizuar me energji elektrike, ashtu që është kyçur drejtpërdrejtë ne rrjet elektrik duke anashkaluar njehsorin elektrik dhe kështu ka shpenzuar energjinë elektrike e cila nuk është e regjistruar;

Nga data 11.09.2020 e deri më datën 07.10.2020, në fshatin S. Komuna e V. me qëllim qe vetës ti sjell përfitim pasuror, ka siguruar shërbime për të cilat e din se janë ne dispozicion ne këmbim të pagesës, në atë mënyrë që e ka furnizuar objektin e vetë me rrymë, pa autorizimin e KEDS-it si furnizues i autorizuar nga cili rrjet furnizues është furnizuar me energji elektrike, ashtu që është kyçur drejtpërdrejtë ne rrjet elektrik duke anashkaluar njehsorin elektrik dhe kështu ka shpenzuar energjinë elektrike e cila nuk është e regjistruar;

Nga data 07.10.2020 e deri më datën 27.05.2021, në fshatin S. Komuna e V. me qëllim qe vetës ti sjell përfitim pasuror, ka siguruar shërbime për të cilat e din se janë ne dispozicion ne këmbim të pagesës, në atë mënyrë që e ka furnizuar objektin e vetë me rrymë, pa autorizimin e KEDS-it si furnizues i autorizuar nga cili rrjet furnizues është furnizuar me energji elektrike, ashtu që është kyçur drejtpërdrejtë ne rrjet elektrik duke anashkaluar njehsorin elektrik dhe kështu ka shpenzuar energjinë elektrike e cila nuk është e regjistruar;

Nga data 27.05.2021 e deri më datën 29.09.2021 në fshatin S. Komuna e V. me qëllim që vetës ti sjell përfitim pasuror, ka siguruar shërbime për të cilat e din se janë ne dispozicion ne këmbim të pagesës, në atë mënyrë që e ka furnizuar objektin e vetë me rrymë, pa autorizimin e KEDS-it si furnizues i autorizuar nga cili rrjet furnizues është furnizuar me energji elektrike, ashtu që është kyçur drejtpërdrejtë ne rrjet elektrik duke anashkaluar njehsorin elektrik dhe kështu ka shpenzuar energjinë elektrike e cila nuk është e regjistruar;

Nga data 29.09.2021 e deri më datën 27.10.2021, në fshatin S. Komuna e V. me qëllim që vetës ti sjell përfitim pasuror, ka siguruar shërbime për të cilat e din se janë ne dispozicion ne këmbim të pagesës, në atë mënyrë që e ka furnizuar objektin e vetë me rrymë, pa autorizimin e KEDS-it si furnizues i autorizuar nga cili rrjet furnizues është furnizuar me energji elektrike, ashtu që është kyçur drejtpërdrejtë ne rrjet elektrik duke anashkaluar njehsorin elektrik dhe kështu ka shpenzuar energjinë elektrike e cila nuk është e regjistruar;

Me këtë ka kryer veprën penale Vjedhja e shërbimeve nga neni 314 par.6 në lidhje me par.1 ne lidhje me nenin 77 të KPRK-së.

Andaj, gjykata konform dispozitave të neneve 4, 7, 17, 21, 38, 43, 69, 70, dhe nenit 314 të KPRK-së, si dhe nenit 450, 463 dhe 495 të KPPK-së, e

G J Y K O N

TË PANDEHURIT: S. C. ,i shqipton DËNIM ME GJOBË në shumën prej pesëqind (500) euro, i cili dënim do të ekzekutohet në afat prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Në rast se i akuzuari refuzon të paguajë këtë dënim me gjobë, atëherë ky dënim me gjobë do të shndërrohet në dënim me burg, duke i caktuar të akuzuarit për çdo njëzetë (20) euro të dënimit me gjobë, nga një (1) ditë burgim.

DETYROHET i pandehuri S. C. që në emër të kompensimit të dëmit palës së dëmtuar KEDS të i'a paguaj shumën e dëmit në vlerë prej 1,706,08 euro.

DETYROHET i pandehuri që në emër të paushallit gjyqësorë të paguajë shumën prej tridhjetë (30) euro.

Të gjitha këto në afat prej 15 ditësh prej ditës së marrjes së formës së prerë të këtij aktgjykimi nën kërcënimin e ekzekutimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Mitrovicë – Departamenti i Përgjithshëm ka paraqitur aktakuzë PP-II.nr.174/22, e datës 24.03.2022, kundër të pandehurit S. C. nga fshati S. i e. komuna e V. për

shkak të veprës penale Vjedhja e shërbimeve nga neni 314 par.6 në lidhje me par.1 në lidhje me nenin 77 të KPRK-së.

Gjykatës i është kërkuar që kundër të akuzuarit të jep Urdhër Ndëshkimor me arsyetimin e besueshëm nga kallëzimi penal dhe provat e bashkangjitura lidhur me bazueshmërinë e aktakuzës së prokurorisë së shtetit në drejtim të vërtetimit të fakteve se i akuzuari vërtetë e ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet.

Me dispozitat ligjore të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, për veprën penale me të cilën akuzohet i pandehuri S. C. ligjvënësi ka paraparë dënim me gjobë ose dënim me burgim deri në tre (3) vjet, që nënkupton se në rastin konkret zbatohen dispozitat ligjore të procedurës së veçantë nga neni 495 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës.

Me rastin e shqyrtimit paraprak të çështjes e konform nenit 493 dhe 494 të KPPK-së, Gjyqtari i vetëm gjeti se janë plotësuar kushtet nga neni 493 të KPPK-së dhe konform dispozitave nga neni 495 par.1 të KPPK-së ashtu që morri vendim që ta pranojë kërkesën për dhënien e urdhrin ndëshkimor si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata konsideron se provat e bashkangjitura në shkresat e lëndës: Procesverbali nr.... i datës 27.10.2021, Foto – dokumentacioni në shtojcë prej pesë (5) fotografive, Faturë DPRHP... e datës 28.10.2021, raport i kalkulimit të rikthimit të humbjeve e datës 28.10.2021, procesverbal nr.... i datës 29.09.2021, Foto – dokumentacioni në shtojcë prej pesë (5) fotografive, raport i kalkulimit të rikthimit të humbjeve i datës 30.09.2021, Faturë DPRHP ... e datës 30.09.2021, Procesverbal nr.... i datës 27.05.2021, , Foto – dokumentacioni në shtojcë prej pesë (5) fotografive i datës 27.05.2021, raport i kalkulimit të rikthimit të humbjeve i datës 28.05.2021, faturë DPRHP..., e datës 28.05.2021, procesverbal nr.... i datës 27.10.2020, Foto – dokumentacioni në shtojcë prej shtatë (7) fotografive i datës 07.10.2020 raport i kalkulimit të rikthimit të humbjeve i datës 08.10.2020, faturë DPRHP... i datës 08.10.2020, Procesverbali nr.... i datës 11.09.2020, Foto – dokumentacioni në shtojcë prej tetë (8) fotografive, Faturë DPRHP... e datës 14.09.2020, raport i kalkulimit të rikthimit të humbjeve e datës 14.09.2020, Procesverbali nr. ... i datës 29.08.2020, Foto – dokumentacioni në shtojcë prej katër (4) fotografive, i datës 29.08.2020 Faturë DPRHP... e datës 01.09.2020, raport i kalkulimit të rikthimit të humbjeve e datës 01.09.2020, Procesverbali nr.... i datës 11.06.2018, Foto – dokumentacioni në shtojcë prej dy (2) fotografive, Faturë DPRHP... e datës 14.06.2018, raport i kalkulimit të rikthimit të humbjeve e datës 14.06.2018, Procesverbali nr.... i datës 23.03.2018, Foto – dokumentacioni në shtojcë prej dy (2) fotografive, Faturë DPRHP... e datës 27.03.2018, raport i kalkulimit të rikthimit të humbjeve e datës 27.03.2018, Procesverbali nr... i datës 23.09.2017, Foto – dokumentacioni në shtojcë prej katër (4) fotografive, Faturë DPRHP. e datës 27.09.2017, raport i kalkulimit të rikthimit të humbjeve e datës 26.09.2017, Procesverbali nr.21229866 i datës 19.08.2017, Foto – dokumentacioni në shtojcë prej katër (4) fotografive, Faturë DPRHP1722518 e datës 24.08.2017, raport i kalkulimit të rikthimit të humbjeve e datës 24.08.2017, tabelë e përmbajtjes së rastit nr. KT/II nr., procesverbal i marrjes në pyetje për të dyshuarin S. C. i datës 22.03.2022, fletëpagesë e datës 11.03.2022, janë prova të besueshme vërtetoi se në veprimet e të akuzuarit ekzistojnë elemente të veprës Vjedhja e shërbimeve nga neni 314 par. 6 lidhur me par.1 në lidhje me nenin 77 të KPRK-së, për këtë edhe i shqiptoi urdher ndëshkimor si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Me rastin e caktimit të lartësisë së dënimit me gjobë gjykata morri parasysh rrethanat si: shkallën e përgjegjësisë penale, meqë rast vepra është kryer me dashje nga ana e të pandehurit, intensitetin e rrezikimit apo dëmtimit të vlerës së mbrojtur në këtë çështje penale, rrethanat në të cilat është kryer vepra penale.

Andaj gjykata vlerësoi se edhe me këtë dënim të shqiptuar do të arrihet qëllimi i dënimit në vështrim me nenin 38 të Kodit Penal të RKS-së, që të parandaloj kryesin nga kryerja e veprës penale në të ardhmen, vepra këto të cilat janë në rritje e sipër, të bëjë rehabilitimin e tij, që në të ardhmen i pandehuri të ketë kujdes të shtuar që të mos bie në kundërshtim me ligjin, pasi që gjykata mundet të ashpërsojë dënimin kundër tij, si dhe me këtë dënim shpreh gjykimin shoqëror për veprën penale të kryer dhe ngritë moralin dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale gjykata e ka marrë në bazë të nenit 450 par.2 nën par.2.6 të KPP-së.

Vendimin lidhur me kompensimin e dëmit të shkaktuar palës së dëmtuar KEDS gjykata e ka marrë në bazë të nenit 463 par. 2 të KPPK-së, ku është përcaktuar se: *“Në aktgjykim me të cilin i akuzuari shpallet fajtor, gjykata mund të vendosë për kërkesën pasurore juridike të të dëmtuarit në tërësi ose pjesërisht dhe për pjesën e mbetur e udhëzon në kontest civil. Kur të dhënat e mbledhura në procedurë penale nuk paraqesin bazë të sigurt për gjykim të plotë e as të pjesërishtëm, gjykata e udhëzon të dëmtuarin që kërkesën pasurore juridike mund ta realizojë në kontest civil”*.

Me sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË – DEGA NË VUSHTRRI

Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal

P.nr.101/22, datë 05.09.2022

Procesmbajtësja
Bahrije Smakolli

GJYQTARI
Agron Maxhuni

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet kundërshtimi në afat prej 8 ditëve nga dita e marrjes me shkrim. Kundërshtimi i drejtohet kësaj gjykate me shkrim apo me gojë në procesverbal të gjykatës.